



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA

Programi Strategjik afatshkurtër dhe afatmesëm  
2015-2020

**Hyrje**

Qeveria e Shqipërisë ka miratuar një sistem përfaqësues të zonave të mbrojtura (ZM), që shtrihet në pothuajse 16% të territorit të vendit. Baza e sistemit të zonave të mbrojtura konsiston kryesisht në 15 parqe kombëtare, disa rezervate natyrore të menaxhuara e pejzazhe të mbrojtura, në të cilat strehohen vlerat më të mëdha natyrore dhe biodiversitetit në vend. Përveç kategorive kryesore, ka filluar të jetë prezent edhe kategoria e Parqeve Natyrore Rajonal (PNR) që lidhet me iniciativat dhe vendimet e organeve vendore.

Tabela përmbledhëse e sistemit të zonave të mbrojtura jepet ne tabelën më poshtë:

Kategorite e Zonave te Mbrojtura	Pershkrimi i kategorisë	Numri	Sip.ha	%
Rezervat Strikt Natyror/ Rezervat Shkencor (IUCN Kat. I)	Territore jo më të vogla se 50 ha, me vlera natyrore të veçanta qe nuk lejohet asnje nderhyrje	2	4,800.00	1.04
Park Kombëtar (IUCN Kat. II)	Territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, ku ne disa pjese te tij lejohet turizmi dhe rekreacioni	15	210,501.40	45.76
Monument Natyre (IUCN Kat. III)	Formacioni natyror (përfshirë edhe dru të veçantë), me sipërfaqe deri 50 ha, formacioni i veçantë gjeologjik/gjeomorfologjik, një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore	750	3,470.00	0.75
Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror (IUCN Kat. IV)	Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, veçanërisht të mbrojtura	22	127,180.10	27.64
Peizazh i Mbrojtur (IUCN Kat. V)	Territoret më të mëdha se 1000 ha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me relief të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, etj.	5	95,864.40	20.84
Zonë e Mbrojtur e Burimeve Natyrore të Menaxhuara (IUCN Kat. VI)	Zonat që përfshijnë territore të gjëra e, relativisht, të izoluara dhe të pabanuara, ku hyhet me vështirësi ose rajone që janë ende pak të populluara	4	18,245.00	3.97
Parqet Natyrore Rajonale* (IUCN Kat. IV e V)	Mjedise që janë nën adminstrimin e pushtetit vendor e që kanë vlera natyrore, të tilla si pyje, kullota, rezervuarë, ligatina etj., me rëndësi per komunitetet lokale	4	51,383	
<b>Shuma</b>		<b>798</b>	<b>460,060.90</b>	<b>100%</b>

\* Zonat janë aprovuar nga Keshilli i Qarkut por planet e tyre të menaxhimit nuk janë aprovuar nga Ministria e Mjedisit, prandaj këto zona nuk jane ende pjese e sistemit te ZM-ve

Në kuadër të sipërfaqes së zonave të mbrojtura Ministria po punon që deri në fund të vitit 2016 me shpalljen e disa zonave të tjera të rëndësishme dhe parqeve të tjera rajonal sipërfaqja totale të shkoj më shumë se 18% të territorit të vendit.

Para vendimit për ngritjen e Agjensisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), menaxhimi i tyre ishte përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit, që përfshihej në detyrat e drejtorive të shërbimit pyjor në rrethe. Për shumë prej këtyre zonave të mbrojtura tashmë janë hartuar planet për menaxhimin, por pak prej aktiviteteve të programuara prej këtyre planeve janë zbatuar ose nuk ka pasur mundësi të zbatohet, si për arsye financiare ashtu edhe numrin e stafit të angazhuar. Deri në momentin e shpalljes së Agjensisë kanë qënë të punësuar rreth 150 punonjës në të gjithë vendin por që nuk kanë qënë plotësisht në dispozicion të këtij sektori pasi prioriteti i jepej aktivitete që lidheshin me pyjet.

### ***Problematika***

Megjithë punën dhe progresin e shënuar në këtë drejtim, kryesisht kjo e lidhur me rritjen e sipërfaqeve të ZM-ve, një seri çeshtjesh dhe mangësish mbeten për tu adresuar si:

- (i) krijimi, funksionimi jo i duhur i administratave të zonave të mbrojtura, mungesa e personelit të nevojshëm në zonë dhe kapacitetet e tyre;
- (ii) cilësia dhe zbatueshmëria e planeve të menaxhimit për ZM-te;
- (iii) mungesen e mjeteve dhe te burimeve financiare për zbatimin e detyrave të vëna;
- (iv) zbatimin dhe promovimin e praktikave lokale/tradicionale të përdorimit e planifikimit të territorit, dhe të zhvillimit të eko-turizmit miqësor me mjedisin;
- (v) vleresimin dhe ruajtjen e bimeve dhe kafsheve te rrezikuara brënda dhe jashte sistemit te zonave te mbrojtura por qe do të jenë pjese e rrejtit Natyra 2000 (si kërkesë e anëtarësimit në BE).

Gjithashtu zonat e mbrojtura asnjëhere nuk arriten në këto 20 vitet e ekonomise se tregut te integrohen si duhet ne politikat kombetare dhe lokale, per tu bere pjese e zhvillimit ekonomik te rajoneve dhe te vendit.

Dobësitë, mangësitë, mundësitë e reformimit, problematikat dhe zgjidhjet janë diskutuar me përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit, me ekspertë vendas e të huaj, kryesisht kjo gjatë vitit 2014-2015. Gjithë palët kanë rënë dakort se procesi i ristrukturimit, përmirësimit, fuqizimit dhe realizimit të një administrate efikase të zonave të mbrojtura në Shqipëri kërkon përfshirjen në mënyrë vërtet aktive të palëve të shumta të interesuara, administratave, institucioneve, OJF-ve dhe të publikut. Kjo do të jetë filozofia e punës në të ardhmen.

### ***Vizioni***

Zonat e Mbrojtura në Shqipëri kthehen në territore për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës e biodiversitetit, duke promovuar vlerat e tyre të shumëllojshme (turistike/rekreative, kulturore, gastronomike, estetike, pejsazhistike, shëndetësore, shpirtërore, etj.), në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm me ndikim pozitiv të komuniteteve lokale dhe rritjes së mirëqënies së tyre.

### ***Qellimi dhe objektivat kryesore***

Qellimi kryesor i punës së AKZM do të jetë përmirësimi i menaxhimit të zonave të mbrojtura sipas kërkesave dhe standarteve ndërkombëtare dhe eksperiencës së vendeve Europiane, duke ruajtur dhe përdoruar në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore në to.

Objektivat kryesorë të programit janë:

- për dy vitet e ardhshme sistemi i zonave të mbrojtura të menaxhohet dhe administrohet nga stafi i AKZM dhe Administratës Rajonale të ZM-ve (AdZM);
- të ngrihet dhe zbatohet një sistem menaxhimi i qëndrueshëm financiar për zonat e mbrojtura, përfshirë edhe aprovimin e një fondi të veçantë për to, me kontributin e të ardhurave nga zonat, donatorët dhe buxhetit të institucionit;
- në katër vitet e ardhshme zonat e mbrojtura dhe vlerat e tyre janë të njohura dhe të promovuar në mënyrë adeguate në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- futja e elementëve të rinj që lidhen me komunikimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin për të ndryshuar perceptimin dhe rolin e këtyre zonave për ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

### ***Drejtimit kryesorë të programit***

Mbi bazën e objektivave kryesorë, aktivitetet e programi strategjik për periudhën 5 vjeçare do të ketë tre shtylla kryesore ku do të mbështetet puna e AKZM-së.

#### ***1. Menaxhimi efektiv dhe qeverisja e Zonave të Mbrojtura***

Do të jetë shtylla kryesore dhe më e rëndësishme, për të qënë edhe treguesi i punës dhe rezultateve të AKZM. Në këtë kontekst hapi i parë lidhet me stafin që do të punojë në këtë institucion, si në qëndër edhe në rrethe, por sukcesi i punës do të lidhet me praninë e tyre në zonën e mbrojtur ku do të caktohen. Një administratë e përkushtuar, e motivuar, punonjës të trajnuar dhe staf i pajisur në mënyrë adeguate, do të jenë çelsi për të arritur një menaxhim efektiv dhe qeverisje të zonave të mbrojtura. Draftimi i nje ligji të ri për ZM-të dhe plotësimi i paketës ligjore, do të mbështesë menaxhimin efektiv dhe do të garantojë fuqizimin e zbatimit të ligjshmërisë nga ana e stafit të “Rangers-ve” (rojet mjedisore). Nga ana tjetër nëpërmjet investimeve me buxhetin e shtetit dhe me mbështetjen e donatorëve mendohet që në dy vitet e ardhshme të ngrihet dhe përmirsohet infrastruktura e nevojshme dhe inventari i paisjeve duke krijuar kushte më të mira për punë.

Vlerësimi i përgjithshëm i sistemit të zonave të mbrojtura, veçanërisht për pjesën që lidhet me përshtatjen e kategorive të IUCN-së që janë zbatuar në vend si edhe kontributin dhe efektivitetin e këtyre zonave në drejtim të mbrojtjes së natyrës, do të japë ndihmesë në shpërndarjen e burimeve njerëzore dhe financiare në këto zona.

Ngritja e kapaciteteve dhe trajnimet në të gjitha nivelet e administratës së ZM-ve, është kërkesë e domosdoshme për menaxhimin e tyre të suksesshëm, si në drejtim të menaxhimit të zonave sipas standarteve ndërkombëtare dhe pritshmërisë që ato kanë ashtu edhe në transmetimin për publikun e gjërë të principeve për ruajtjen, mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë. Plani për rritjen e kapaciteteve dhe trainimeve do të targetojë çdo anëtar të stafit të administratës së ZM-ve me qëllim që ato të jenë në gjëndje të zbatojnë detyrat e tyre me standarte të larta, duke përdorur përjasje moderne në fushën e tyre të ekspertizës.

#### ***2. Financimi i qëndrueshëm i zonave të mbrojtura***

Që stafi i AKZM-së dhe AdZM-së të punojë për menaxhimin efektiv të ZM-ve, ai ka nevojë për tu mbështetur me burime të përshtatshme financiare, që lejojnë aktivitetet menaxhuese dhe mirëmbajtjen e paisjeve dhe infrastrukturës së nevojshme. Kjo do të fillojë me

inventarizimin e asetëve infrastrukturore (ndërtesa, investime të kryera, mjete, paisje, etj.) dhe vlerësimin e efektivitetit të tyre në mbështetje të menaxhimit të zonave. Gjetja e mekanizmave për gjenerimin e të ardhurave dhe aktivitetet/rrugët për ti shpenzuar/zbatuar në zonat e mbrojtura do të jetë një prioritet i vazhdueshëm. Ky proces do të lidhet me mbështetjen e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm në territoret e zonave sipas kërkesave të legjislacionit dhe standarteve ndërkombëtare. Një tjetër prioritet do të jetë edhe sigurimi i një koordinimi më të mirë dhe më me efektivitet me donatorët për të rritur efektivitetin e sinergjinë e ndërhyrjeve. Komunikimi i vazhdueshëm dhe bashkëpunimi me institucionet e huaj/donatorët do të rrisë mbështetjen financiare për zonat e mbrojtura. Qellimi final do të jetë ngritja e një fond i veçantë për Zonat e Mbrojtura si një mundësi më e mirë për të rritur mbështetjen për mirëmenaxhimin e tyre.

### *3. Komunikimi dhe rritja e ndërgjegjësimit*

Në procesin e mbrojtjes së natyrës në vend do të ishte me rëndësi të madhe që zonat e mbrojtura janë të njohura dhe të vlerësuara nga publiku i gjërë dhe nga grupet e interesuara. Aktivitete në këtë drejtim do të fokusohen si në vizibilitetin e AKZM-së, si institucioni përgjegjës për menaxhimin e ZM-ve, ashtu edhe në promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit për Sistemin e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri, duke e bërë më të qartë dhe prezent konceptin e zonës së mbrojtur dhe çfarë ato përfaqësojnë. Do të merren shumë inisiativa që lidhen me mediat vizive e shkruar, takime, promovime, etj. Procesi do të pasurohet me elementë edukativ duke rritur funksionin dhe ndikimin e zonave të mbrojtura. AKZM do të zhvillojë një faqe të re interneti me elementë të rinj dhe do ketë prezencë të vazhdueshme në rrjetet sociale. Do të shfrytëzohen festat dhe mundësitë lokale për të promovuar vlerat e zonës dhe pjesmarrjen e publikut, por edhe bashkëpunimin me sistemin e shkollave nëpër rrethe.

**PLANI I DETAJUAR I PUNËS PËR ZONAT E MBROJTURA**

Nr.	Përshkrimi masave që do meren në zbatim të objektivit	Përcaktimi i treguesve për vlerësimin dhe realizimin e çdo mase	Institucionet/personat përgjegjës	Afati përfundimtar
<b>I. Menaxhimi dhe mirëadministrimi i ZM-ve</b>				
1.	Plotësimi dhe rritja e numrit të stafit në AKZM me dhe ndarja e zonave të mbulimit brenda çdo Qarku	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Emerimi i punonjesve të AKZM-se dhe Administratës në Qarqe</li> <li>• Miratimi i kontratave të punës</li> <li>• Ndarja e territoreve të mbulimit në ter'ritrin e Qarkut</li> <li>• Plotësimi i stafit me punonjës të rinj në bazë të shtimit të sipërfaqes së zonave të mbrotura</li> </ul>	Ministria e Mjedisit Drejtori i Përgjithshëm	E vazhdueshme
2.	Hartimi i akteve ligjore si edhe rishikimi i ligjit bazë bashkë me aktet e tjera nënligjore që lidhen me funksionimin e administratës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hartimi i rregullores së funksionimit</li> <li>• Përshkrimi i vendeve të punës në administratë</li> <li>• Hartimi i një ligji të ri për ZM-te dhe dërgimi i tij për aprovim</li> <li>• Përgatitja e një pakete me të gjithë vendimet e qeverisë të nevojshme</li> </ul>	Drejtori i Përgjithshëm Juristi në AKZM Ministria e Mjedisit Eksperte të jashtëm	Prill 2016
3.	Paisja me mjete dhe paisje për pjesën më të madhe të administratës së zonave të mbrojtura me buxhetin e shtetit dhe kontributin e donatorëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Paisja me mjete të lëvizshme (makina dhe motorra) për të gjitha Qarqet.</li> <li>• Paisje me kompjutera (me një mesatare 3 për çdo qark) dhe paisje për zyrat.</li> <li>• Përgatitja e uniforma për të gjithë AdZM-të e vendit</li> </ul>	Ministria e Mjedisit Drejtori i Përgjithshëm Drejtoret e AdZM-ve Projekte e donatorët	Dhjetor 2016
4.	Rivendosja në funksionim të godinave/zyrave në zonat e mbrojtura	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Venia në funksionim të të gjithë zyrave të Qarqeve, dhe godinave që do të trashëgohen nga DSHP-të</li> <li>• Rehabilitim i qendrave të informacionit egzistuese (PK Dajt, Velipoje, Valbone, etj.)</li> <li>• Ngritja e qendrave të reja të informacionit (Prespë, Theth, Divjakë, Librazhd, Llogora, etj.)</li> </ul>	AKZM Drejtoret e AdZM-ve Projekte e donatorë	Dhjetor 2016

5.	Inventarizimi dhe identifikimi i aktiviteteve te ligjshme dhe te paligjshme në territoret e zonave te mbrojtura, problemeve madhore qe lidhen me mirefunksionimin e çdo zone dhe raportet me aktoret e tjera ne zone (peshkatare, restorante, sherbime, organe vendore, etj.)	Raporti final per secilen zone te mbrojtur me çeshtjet te kerkuara	AKZM Drejtorët e AdZM-ve	Mars 2016
6.	Aprovimi dhe rishikimi i planeve të menaxhimit të hartuar, duke analizuar problematikat që përmbajnë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aprovimi i të gjithë planeve të hartuar qe nuk janë bërë (PKD Karaburun-Sazan, PK Divjakë-Karavasta, etj.)</li> <li>• Përfundimi dhe aprovimi i planeve që janë në proces (PK Shebenik-Jabllanicë, PM Bunë-Velipojë)</li> <li>• Hartimi dhe aprovimi i planeve të reja (PK i Alpeve, RNM e Porto Palermos)</li> <li>• Rishikimi i Planeve që kanë mbaruar afatin (PK Dajt, PK Llogora, RNM e Karaburunit, PM Vjosë-Nartë)</li> <li>• Vleresimi i mangesive per planet e menaxhimit te hartuara 4 vitet e fundit</li> <li>• Hartimi i planeve te veprimit per 3 vitet e ardhshme</li> </ul>	AKZM Drejtorët e AdZM-ve	Janar 2017
7.	Monitorimi dhe kontrolli i siperfaqeve te zonave te mbrojtura si edhe identifikimi i rasteve ku nuk zbatohet ligji	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e sistemit të monitorimit dhe patrullimit në vendet e rëndësishme te kalimit</li> <li>• Grumbullimi i informacioneve nga institucionet dhe grupet e tjera te interesit</li> <li>• Hartimi i raporteve mujore me gjetjet dhe sugjerimet e mundshme</li> <li>• Monitorime të vazhdueshme të punës së AdZM-ve në terren</li> </ul>	AKZM Drejtorët e AdZM-ve	E vazhdueshme
8.	Mbështetja e aktiviteteve ekonomike të qëndrueshme dhe tradicionale brënda zonave të mbrojtura	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Koordinimi i punës me projektet që zbatohen në zonat e mbrojtura kryesisht në fushën e turizmit</li> </ul>	AKZM AdZM	E vazhdueshme

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbeshtetja e turizmit gjatë gjithë periudhës së vitit</li> <li>• Zhvillimi i nje aplikacioni për turizmin në zonat e mbrojtura</li> <li>• Rritja e aktivitetve rekreative të qëndrueshme dhe nxitja e aktiviteteve të reja</li> </ul>		
9.	Riformatimi i Komitetet e Menaxhimit për çdo zonë të mbrojtur me tendecë për fuqizimin dhe decentralizimin e tyre	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rishikimi i te gjithë vendimeve te meparshme te Komiteteve te Menaxhit per ZM-te</li> <li>• Venia ne zbatim te takimeve te rregullta per keto struktura</li> </ul>	AKZM Ministria e Mjedisit	Maj 2016
10.	Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet shtetërore që janë pjesë e menaxhimit të zonave (inspektoriat, AKM-në, drejtori te pergjithshme te menaxhimit te burimeve natyrore, agjensi kombetare, zyra rajonale, etj.)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikimi i aktoreve kryesore ne zonat e mbrojtura qe ndikojne ne menaxhimin e burimeve;</li> <li>• Vendosje e marredhenieve te bashkepunimit mbi baza te qendrueshme dhe zgjidhja e konflikteve</li> </ul>	AKZM Administrata e ZM-ve	Qershor 2016

## **II. Menaxhimi financiar i zonave të mbrojtura**

11.	Inventarizimi dhe auditimi i vlerave të pranishme në ZM-të dhe vënia në funksionim e ndërtesavë në zona	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Marrja ne dorezim dhe plotesimi i dokumentacionit per ndertesat ne ZM-te</li> <li>• Lidhja e kontratave te dritave dhe ujit per te gjitha dhe regjistrimi i tyre ne hipoteke</li> <li>• Marrja e te gjithë godinave/ndertimeve te lena ne harese per tu kthyer ne qendra funksionale</li> </ul>	AdZM dhe AKZM Ministria e Mjedisit	Janar 2016
12.	Ndryshimi i menaxhimit financiar të Agjencisë me ndryshimet në ligj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndryshimi i ligjit për menaxhimin e të ardhurave nga zonat e mbrojtura</li> <li>• Aprovimi i tij dhe aprovimi i udhëzimit të përbashkët për përdorim</li> <li>• Vënia në zbatim</li> </ul>	AKZM Ministria e Mjedisit Ministria e Financave	Maj 2016
13.	Studimi dhe zbatimi i nje plani te ri për menaxhimin financiar për disa zona (PK Dajt, PK Divjakë-Karavasta, PK Llogora), ne varesi edhe te fillimit te projektit te UNDP-se	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Raporti final per territorin e zoneve te mbrojtura me opsionet e mundshme per gjenerimin e te ardhurave</li> <li>• Zbatimi ne tre zona te mbrojtura pilot i</li> </ul>	AKZM dhe AdZM Eksperte te huaj	Shtator 2017

		mekanizmave financiar te gjenerimit te te ardhurave		
14.	Studimi dhe zbatimi i koncepteve per gjenerimin e te ardhurave dhe shtimin e stafit ne zonat e mbrojtura	Raporti final per territorin e zoneve te mbrojtura	AKZM Eksperte te huaj	Dhjetor 2016
15.	Rritja e buxhetit te Agjensise per kostot operative te funksionimit te aminstrates se zonave te mbrojtura	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Perllogaritja e kostove minimale per kontrollin e zonat e mbrojtura</li> <li>• Studimi i nevojave infrastrukturore per mirefunksionimin e agjensise</li> </ul>	Drejtori i Pergjithshem Eksperte te huaj e vendas	Janar 2015
16.	Konkretizimi i mundësise për të krijuar një fond të veçantë për zonat e mbrojtura, me kontributin e të ardhurave nga aktivitetet në zonat e mbrojtura por edhe të donatoreve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e një tryeze pune me donatoret për rregullimin dhe rritjen e efijencës së financimit të huaj për ZM-të</li> <li>• Takim pune në muajin Nëntor 2015 për koordinimin e projekteve dhe rritjen e efijencës</li> <li>• Takime me perfaqësues të Ministrise së Financave për krijimin e një fondi brënda struktures buxhetore</li> </ul>	Drejtori i Pergjithshem Eksperte te huaj Donatoret (UNDP, WB, SIDA, GIZ, KfW, DGCS, IUCN, WWF)	Mars 2017
<b>III. Vleresimi i sipërfaqeve të zonave të mbrojtura në vend</b>				
17.	Vlerësimi i situatës për sipërfaqet e zonave të mbrojtura dhe të zonimit brënda tyre	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i grupit të punës me përfaqësues nga të gjithë institucionet</li> <li>• Identifikimi i problematikave dhe prezantimi i zgjidhjeve</li> <li>• Përgatitja e akteve nënligjorë për aprovimin e tyre</li> </ul>	AKZM dhe AdZM Ministria e Mjedisit Org. Shoqërisë Civile	Janar 2016
18.	Propozimi per krijimin e zonave të reja të mbrojtura (Porto Palermos, Parku i Alpeve, etj.) dhe heqja e atyre të panevojshme ose nën presionin e zhvillimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Paraqitja e projekt propozimit ne KM me te gjithë dokumentat e plotësuar</li> <li>• Plotesimi i dokumentacionit per shpalljen e parkut te madh të Alpeve</li> <li>• Shpallja dhe inagurimi i zonave të reja</li> <li>• Identifikimi i territoreve dhe zonave për tu hequr nga sistemi i zoave të mbrojtura</li> </ul>	Drejtori i Pergjithshem AKZM Org. Shoqërisë Civile	Maj 2016
19.	Shpalljen e Parqeve Natyrore Rajonale (PNR)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Studimi e pergatitja e nje manuali udhezues</li> </ul>	Drejtori i Pergjithshem	Në vazhdim



	nje risi pozitive ne zonat e mbrojtura me perfshirjen e organive vendore	<p>per procedurat e shpalljes se nje PNR</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi i nje konference/workshopi me perfaqesuesit e Qarqeve per modelimin e procedurave te ketyre zonave.</li> <li>• Pergatitja e dokumentacionit per shpalljen e kater zonave te reja</li> </ul>	AKZM Org. Shoqërisë Civile Organet vendore	
20.	Studimi i kerkesave/standarteve ligjore dhe siperfaqeve aktuale te zonave te mbrojtura	Raporti final per territorin e zoneve te mbrojtura	AKZM Eksperte vendas & huaj	Qershor 2016
21.	Studimi i zbatimit te principeve dhe kerkesave per kategorite dhe qeverisjen e ZM-ve.	Raporti final per territorin e zoneve te mbrojtura	AKZM Eksperte vendas & huaj	Dhjetor 2016
<b>IV. Ngritja e kapaciteteve të stafit dhe komunikimi</b>				
22.	Planifikimi i trajnimeve të stafit në grupe, me parimet e funksionimit të zonave të mbrojtura dhe detyrat e stafit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitja e nje manuali trajnimi dhe/ose një shkolle për stafin e zonave të mbrojtura</li> <li>• Organizimi i trajnimeve të rregullta në vit</li> <li>• Testimi i punonjësve të trajnuar</li> </ul>	Drejtori i Pergjithshem AKZM dhe Administrata OSHC	Per çdo vit
23.	Shkëmbimi i rregullt i informacionit dhe eksperiencave brenda stafit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi i takimeve tremujore me të gjithë drejtuesit e stafit të AdZM-ve</li> <li>• Organizimi i takimeve gjashtëmujore me të gjithë stafin e punonjësve</li> <li>• Organizimi i vizitave të shkëmbimit të eksperiencave pozitive në punë</li> </ul>	Drejtori i Pergjithshem AKZM dhe AdZM	Per çdo vit
24.	Përgatitja dhe shpërndarja e modeleve për grumbullimin e të dhënave në terren dhe hedhjen e tyre në sisteme database	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitja e skedave të marrjes së të dhënave individuale</li> <li>• Organizimi i trajnimeve në terren për grumbullimin e informacionit</li> <li>• Hedhja e të dhënave në database rajonal dhe pastaj qëndror</li> </ul>	AKZM dhe AdZM-të OSHC	Dhjetor 2015
25.	Përfshirja në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies të edukimit për natyrën	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Firmosja e marrëveshjeve me Drejtoritë Arsimor në Qarqe për vizitat e organizuara të shkollave</li> <li>• Përgatitja e paketave edukative për nxenesit e</li> </ul>	AKZM dhe AdZM OSHC	Qershor 2016

		shkollave 9-vjeçare • Organizimi i orëve të hapura dhe vizita të rregullta me nxënësit e shkollave		
26.	Rritja e elementeve të komunikimit me publikun dhe mediat	• Hapja e nje faqeje te re për AKZM-në dhe prezencë e çdo AdZM ne rrjetet sociale me elemente aktiv për zonat e mbrojtura • Vendosja e logove identifikuese për secilin nga zonat e mbrojtura kryesore të vendit • Organizimi i vizitave të gazetareve në zonat e mbrojtura të panjohura për publikun • Organizimi i festave lokale dhe ditët e shënuara mjedisore për të promovuar zonat e mbrojtura	Drejtori i Pergjithshem AKZM dhe AdZM Ministria e Mjedisit OSHC	Per çdo vit

### ***Për objektivat afatgjatë***

Në termat afat gjatë Agjensia do të kërkoj të luaj një rol në zhvillimin e politikave dhe strategjive për ruajtjen e mbrojtjen e natyrës në përgjithësi. Fillimi i procesit për rritjen Natura2000 do të kërkojë një përqasje të ndryshme për ruajtjen e habitateve dhe specieve. Kjo do të lidhet edhe me rritjen e numrit të punonjësve dhe kualifikimin e tyre. Do të jetë një prioritet afatgjatë edhe kërkesa për zbatimin e ligjit, kontrollin dhe ndalimin e aktiviteve të paligjshme. Nga ana tjetër koncepti “Ranger” ose “Roje Mjedisore” do të lidhet me shumë funksione që duhet të kryej një punonjës i tillë si edukimi, menaxhimi, guida natyrore, turizmi, etj., prandaj përfshirja në këtë kontigjent i personave me arsimin e duhur, integritetin moral, dashurinë dhe pasionin e punës, shpirt sakrificë, janë domosdoshmëri me objektivin afatgjatë që pas 4 viteve të ardhshme të formohet një trupë administrate me kërkesat e kohës.

Administrata e zonave të mbrojtura që në vitin 2015 po krijohet në bazë të ndarjeve administrative (Qarqeve), por në procesin e zbatimit të programit të punës do të fillojë të konsiderohet mbi bazë të territoreve të zonave të mbrojtura. Binomi ZM-administratë duhet të bëhet çelsi i suksesit për proceset e të ardhmes. Nga njëra anë sistemi i Agjensisë bën të mundur planifikimin financiare dhe të punës për zonat e mbrojtura, por nga ana tjetër nuk duhet të pengojë procesin e mëvetësisë dhe organizimit të zonës së mbrojtur mbi bazën e kapaciteteve lokale dhe mbështetjes së aktorëve lokale (organet vendore, shoqëria civile, bizneset private, grupet e interesit, etj.).

Duke pasur parasysh vështirësitë dhe mangësitë e pritshme në staf dhe buxhet e AdZM-ve, do të fillojë puna për hartimin e një programi të veçantë për vullnetarizmin, bazuar në eksperiencat e vendeve Europiane. Kjo do të bëjë të mundur përfshirjen e sa më shumë personave në ruajtjen e zonave, dhe mund të krijoj një trup mbështetëse me atë të administratës.

**Zamir DEDEJ**

**Drejtor i Përgjithshëm**